



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KUVENDI KOMUNAL

01 Nr. 17/26

Më 30.04./26

Në bazë të neneve 11, 12 paragrafi 2 shkronja d) dhe nenit 17 shkronja s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB-03/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, lidhur me Statutin e Komunës së Mamushës, Kuvendi i Komunës së Mamushës, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 30.04.2026, miraton këtë:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Neni 1

Themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Mamushës, në këtë përbërje:

1. Abdülhadi Krasniç-Kryetari i Komunës (Kryesues);
2. Enis Orçusha- Komandanti i Stacionit të Policisë në komunën e Mamushës;
3. Rujdi Sala- Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës përkatëse;
4. Agim Zogaj -Shqiptar dhe Kujtim Berisha nga Komuniteti Rom- përfaqësues i secilit komunitet etnik të komunës përkatëse;
5. Halim Sadiku-Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës;
6. Seylan Alaybeg Zyrtari për Barazi Gjinore;
7. Buyar Mazrek-Drejtori i Drejtorisë për Arsim;
8. Semra Morina Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të komunës përkatëse;
9. Toger Vedat Shatri- Një përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK);
10. Rahman Morina-Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale;
11. Ajet Sadiki Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim;
12. Samidin Taç-komunitetit të biznesit
13. Cemil Taç-Nga një përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, dhe komunitetit të personave me aftësi të kufizuara.

Neni 2

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi themelohet për një mandat të njëjtë me atë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ndërsa përbërja e tij mund të ndryshohet apo plotësohet me vendim të veçantë, varësisht nga kërkesat ose nevojat e paraqitura.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit përcaktohen me Udhëzimin Administrativ nr. 27/2012 MPB-03/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës, konform dispozitave të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave.

KUVENDI I KOMUNËS – MAMUSHË

Zyra e Kryetarit
MPB
Drejtoritë
Arkivi

Kryesuesi i Kuvendit

Necmedin Morina

